

Mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore ndaj 24 Vesti

Shkup, 28.12.2018. – Pas një kallëzimi të pranuar, Agjencia realizoi mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore ndaj TV 24 Vesti, në lidhje me respektimin e obligimeve për emetimin e programit në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, kurse në rastet kur programi është i dedikuar për bashkësinë që nuk është shumicë, në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie .

Me mbikëqyrjen u konstatua se në shërbimin programor të TV 24 Vesti, më datë 11 dhe 25 dhjetor 2018, në kuadër të edicionit “24 Otvoreno”, janë emetuar pjesë të emisioneve në gjuhën bullgare, pa siguruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Raporti mund të merret në linkun e mëposhtëm:

24 Vesti – (neni 64 dhe neni 1 nga LSHMAA) – 28.12.2018